



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Tiranë, më 27.10.2020

N J O F T I M

Mbështetur në Vendimin e Rektorit Nr.106, datë 27.10.2020 “Mbi shpalljen e konkursit për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020 – 2021, ne Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), se duke filluar nga data **27.10.2020 deri më 03.11.2020**, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, dokumentacionin përkatës sipas specialiteteve ku aplikon.

I. DEPARTAMENTI I VEPRIMTARISË FIZIKE, REKREATIVE DHE TURIZMIT

- **Disiplina Rekreative II** (Mod.Danc- Folk) **Bachelor** 2 (dy) Lektor, As/Lektor
- **Lëndë me Zgjedhje** (Mod.Koreografi Art Lëvizje) **Bachelor** 1(një) Lektor, As/Lektor
- **Disiplinat e Sport. Individ. Rekreative** (Mod. Komp. Danci) **M.Prof.** 1(një) Lektor
- **Aktiviteti Fizik në Sportet Individuale** (Mod. Koreografi) – **MSH** 1(një) Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për lendet e aplikuara në Departamentin e Veprimtarisë Fizike, Rekreative dhe Turizmit janë si më poshtë:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në nivelin Master Shkencor (ose ekuivalent me të) në Specialitetin e lëndës përkatëse ku konkuron. **15 pikë**
2. Të ketë notë mesatare të studimeve të larta mbi 8 (tetë). **15 pikë**
3. Të ketë përvojë pune Akademike mësimdhënëse e kërkimore në fushën përkatëse në Institucionet e Arsimit të Lartë, preferohet FVFR. **25 pikë**
4. Të zotërojë njërën nga gjuhët e BE: anglisht, frengjisht, spanjisht, gjermanisht, italisht me dëshmi. **10 pikë.**
5. Të ketë njohuri të përdorimit të programeve kompjuterike bazë(me dëshmi). **10 pikë**
6. Kanë preference kandidatët që kanë Grada dhe Tituj shkencor. **15 pikë**
7. Të ketë kryer aktivitet shkencor si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit. **3 pikë**
8. Të ketë eksperiencë në pozicione drejtuese në institucione private/publike në fushat e mësipërme. **1 pikë**
9. Të ketë eksperiencë praktike dhe specializim në fushat e Dancit dhe Koreografisë **3 pikë**
10. Vlerësohen kualifikimet dhe trajnimet e ndryshme brenda dhe jashtë vendit në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës. **3 pikë**
11. Kriteret nga 1) deri në 2) janë kritere bazë dhe kandidati nqs nuk i ka, skualifikohet; kriteret nga 3) deri në 10) janë kritere preferenciale.

II. DEPARTAMENTI I ORGANIZIM DHE MENAXHIMIT.

- **Metodologjia e Kërkimit Shkencor** (Mod. Statistikë e Aplikuar-SPSS)- **Bachelor**
1 (një) Lektor, As/Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për lëndën: Metodologjia e Kërkimit Shkencor (Mod. Statistikë e Aplikuar-SPSS janë si më poshtë:

Kritere bazë

1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve në fushat e Informatikës, Matematikë/Statistikë e aplikuar, Inxhinieri Kompjuterike, TIK, apo fusha të tjera të përfaqësuara me to **(15 pikë)**
2. Për aplikantët me gradë Master i Shkencave:
 - Të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze-me dëshmi) **(10 pikë)**

Kritere preferenciale

3. Preferohen aplikantët që kanë eksperiencë të mësimdhënies në IAL, preferohet në UST **(deri 20 pikë)**
 4. Preferohen kandidatët që kanë grada dhe tituj **(15 pikë)**
 5. Preferohen kandidatët që kanë marrë pjesë në projekte për zhvillim sistemesh informacioni/përpunimi të të dhënave **(deri 15 pikë)**
 6. Vlerësohen kualifikime të ndryshme të detyrueshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës ku aplikojnë **(deri 10 pikë)**
 7. Të ketë veprimtari shkencore si referime, botime ose studime. **(deri 15 pikë)**
- **Marketing në Sport dhe Turizëm**, (Mod. Mark. në Sport & Mark. në Turiz). M.Prof.
1 (një) Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për lëndën: Marketing në Sport dhe Turizëm, (Modulin: Marketing në Sport&Marketing në Turizëm) janë si më poshtë:

Kritere bazë

1. Të ketë së paku gradën shkencore “Doktor” në fushën e Marketingut & Menaxhimit. **(15 pikë)**

Kritere preferenciale

2. Preferohen aplikantët që kanë eksperiencë të mësimdhënies në IAL, preferohet në UST **(deri 20 pikë)**
3. Vlerësohen kualifikime të ndryshme të detyrueshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës ku aplikojnë **(deri 20 pikë)**
4. Preferohen kandidatët që kanë marrë pjesë në projekte ndërkombëtare për menaxhimin e marketingut e sportit/turizmit **(deri 25 pikë)**
5. Të ketë veprimtari shkencore si referime, botime ose studime **(deri 20 pikë)**

- **Menaxhim në Sport & Turizëm (Lëndë me zgjedhje)** (Mod. Menaxhim në Sp.) M.Prof.
- **Aspekte Psikosociale të Menaxhimit në Sport** (Mod.Asp.Psik.Men.Sp.) M.Prof.
1 (një) Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për lëndët: Menaxhim në Sport & Turizëm (Lëndë me zgjedhje) (Moduli: Menaxhim në Sport) dhe Aspekte Psikosociale të Menaxhimit në Sport (Moduli: Aspekte Psikosociale të Menaxhimit në Sport) janë si më poshtë:

Kritere bazë

1. Të ketë së paku gradën Doktor i Shkencave në fushën e Sportit/Ekonomisë **(15 pikë)**

Kritere preferenciale

2. Preferohen aplikantët që kanë eksperiencë të mësimdhënies në IAL, preferohet në UST **(deri 20 pikë)**
3. Preferohen kandidatët që kanë përvojë pune në përcaktimin e politikave dhe zhvillimin e strategjive për menaxhimin e sportit **(deri 20 pikë)**
4. Preferohen kandidatët që kanë marrë pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e sportit **(deri 15 pikë)**
5. Vlerësohen kualifikime të ndryshme të detyrueshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës ku aplikojnë **(deri 15 pikë)**
6. Të ketë veprimtari shkencore si referime, botime ose studime. **(deri 15 pikë)**

III. DEPARTAMENTI I LËVIZJES DHE SHËNDETIT

- **Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti**, (Mod.Parandalimi i Sëmundjeve) M. Shkenc. 1(një) Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për lëndën: Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti, (Moduli: Parandalimi i Sëmundjeve), janë si më poshtë:

1. Të ketë notë mesatare mbi 8-te;
2. Të zotërojë një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze)
3. Kërkohej Lektor me gradat: Dr; Prof. Asc. Dr; Prof. Dr.
4. Diplomimi duhet të jetë në fushën e lëndëve Biomjekësore.
5. Preferohen pedagogët që kanë përvojë në mësimdhënie në shkollën e lartë.
6. Të ketë veprimtari shkencore si: referime, botime.
7. Të ketë njohuri të zotërimit të aftësive kompjuterike dhe programet bazë të tij.
8. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.
9. Të ketë specializim pasuniversitar.

- **Terapia e Lëvizjes**, (Mod.Fizioterapi-masazh)- Bachelor 1(një) As/Lektor

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për lëndën: Terapia e Lëvizjes, (Mod.Fizioterapi-masazh), janë si më poshtë:

1. Të ketë notë mesatare mbi 9-të.

2. Të zotërojë një gjuhë të huaj te njohur nga testet ndërkombëtare. Njoha e gjuhëve të huaja të tjera është avantazh.
 3. Kërkohen Lektor ose As/Lektor.
 4. Diplomimi duhet të jetë në fushën e lëndëve Mjekësore teknike, specialiteti Fizioterapi.
 5. Të ketë njohuri të zotërimit të aftësive kompjuterike dhe programet bazë të tij.
 6. Të ketë veprimtari shkencore si: referime, botime, pjesëmarrje në Konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.
 7. Të ketë përvojë pune në fushën e fizioterapi-masazhit.
 8. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.
- IV. Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm nëpërmjet postës, duke shënuar qarte mbi zarf, pozicionin për të cilin konkurojnë, departamentin, fakultetin, lëndën ku aplikojnë, dokumentacionin e mëposhtëm:
- ✓ Curriculum Vitae (e detyrueshme)
 - ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Bachelor (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
 - ✓ Diplomë dhe Certifikatë e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje e noterizuar) (e detyrueshme)
 - ✓ Certifikatën e gradës “Doktor i Shkencave” (nqse ka) (fotokopje)
 - ✓ Dëshminë e titullit “Profesor i Asociuar” (nqse ka) (fotokopje)
 - ✓ Dëshminë e titullit “Profesor” (nqse ka) (fotokopje)
 - ✓ Fotokopje e kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
 - ✓ Dëshmi penaliteti (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
 - ✓ Numrin e llogarisë bankare (nqse ka) (fotokopje)
 - ✓ Vërtetim nga qendra e punës me lejen për t’u angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR – UST (nqse është i punësuar)
 - ✓ Vetëdeklarim në rast se është i/e papunësuar
 - ✓ Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).
- V. Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- VI. Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti, Departamenti, **specialiteti ku aplikon**, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail e konkurentit.
- VII. Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

REKTOR

Prof. Dr. Agron KASA